



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia
Bashkiake Nr. 5
TEL: 698227426



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2432

Nr. koleksioni: 1815



Tirane më 22/03/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2025053150194819406



MARRËVESHJE PËR SHITBLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot më datë 22.03.2025 (dymijë e njëzet e pesë), para meje Noter ERMAL XH. HAMZAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga: "Pashko Vasa", Pallati Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia Bashkiake Nr. 5, u paraqit personalisht:

1. Shoqëria "New Apollonia" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: M41929022N, me seli në Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 12, kati 11, Zyra 1100, Kutia Postare 1010, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga administrator Znj. Dea Filipi, shtetase shqiptare, lindur më 26/05/1988, në Kucovë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 036324724, dhe me numër personal I85526056B, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (më poshtë referuar si "Shitës")
2. Shoqëria "Blessed Investment" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L71423028S, me seli në adresë rruga Rruga Themistokli Gërmenji, Nd.1, Tiranë, përfaqësuar rregullisht nga administrator Znj. Ana Lleshi (më poshtë referuar si "Blerës")

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si me poshtë:

vijon:

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të 1 (një) kuote me një vlerë nominale prej 1,000 LEK (një mijë lekë), të cilat përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Apolonia Seafront Properties" sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 3, Kati 1, Tiranë, Shqipëri regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: M51321056J, përfaqësuar nga Administratori Znj. Anila Xhepa ("Kuota").
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 1,000 LEK (një mijë lekë), të cilat përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë Apolonia Seafront Properties sh.p.k., dhe të gjitha të drejtat e detyrimit që ai gëzon si ortak, ja kalon blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim të barabartë me 4,500 LEK (katër mijë e pesëqind lekë), (këtu e tutje referuar si "Çmimi").
3. Blerësi do të paguajë brenda pesë ditë pune nga dita e firmosjes së kësaj kontrate çmimin e plotë prej 4,500 LEK (katër mijë e pesëqind lekë), në llogarinë bankare të Shitësit me këto të dhëna:

Emri i Bankës: Tirana Bank SH.A.

Titullari i llogarisë: New Apollonia SHPK

NR.Llogarie: 0190- 327246- 100

IBAN: IBAN AL26 2061 1097 0000 1903 2724 6100

Monedha: ALL

Blerësi angazhohet që brenda pesë ditë pune nga dita e firmosjes së kësaj kontrate, të kthejë huanë prej 70,000 (shtatëdhjetë mijë lekë) Lekë që Apolonia Seafront Properties shpk i detyrohet New Apollonia shpk.



A2025053150194819406

4. Shitësi në këtë mënyrë deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguruese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe në cdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të ketë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e Kuotës së mësipërme.

Në çdo rast vetëm pagesa e plotë e Çmimit nga Blerësi është kusht thelbësor për përfitimin e pronësisë së Kuotës nga Blerësi sipas objektit të kësaj marrëveshjeje. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e Kuotës.


6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe ekzekutohet në zyrën e qendrës së biznesit (QKB) vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2), (3) dhe (5) më lart, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përse i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.
7. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
8. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshjeje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
9. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshjeje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimimi të kësaj marrëveshjeje.
10. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

Kjo Marrëveshje hartohet në 3 (tre) kopje me përmbajtje dhe fuqi të njëjtë ligjore.

PALET KONTRAKTORE


SHITËSI

Dea Filipi
New Apollonia Sh.p.k.
përfaqësuar nga Znj. Dea Filipi



BLERËSI

Ana Lleshi
Blessed Investment Sh.p.k.
përfaqësuar nga Znj. Ana Lleshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M51321056J
2. Data e Regjistrimit	21/01/2025
3. Emri i Subjektit	APOLONIA SEAFRONT PROPERTIES
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	17/01/2025
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/01/2025
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Godina 3 Kati I Tirane
8. Kapitali	1.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	(i) Zhvillimi, projektimi dhe ndërtimi i objekteve civile dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë; (ii) Shitja e objekteve/njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira; (iii) Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt dhe indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar; (iv) Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike etj; (v) Administrimi i bashkëpronësisë në ndërtesa, në resorte apo struktura turistike dhe në komplekse rezidenciale; (vi) Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj; (vii) Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe mos shndërrojnë objektin parësor të veprimtarisë së Shoqërisë.	
10. Administratori/ët	Anila Xhepa	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 17/01/2025	Deri: 16/01/2030
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	New Apollonia	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 1.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: APOLONIA SEAFRONT PROPERTIES E-Mail: a.xhepa@balfin.al Telefon: +355698081303	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 22/03/2025

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2025/03/22 11:49:26 +01:00
M51321056J2025032211491790
2006



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M41929022N
2. Data e Regjistrimit	29/07/2024
3. Emri i Subjektit	New Apollonia
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	23/07/2024
6. Kohëzgjatja	Nga: 23/07/2024
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 12, kati 11, Zyra 1100, Kutia Postare 1010, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, Shqipëri
8. Kapitali	98.050.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	(i) Zhvillimi, projektimi dhe ndërtimi i objekteve civile dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë;(ii) Shitja e objekteve/njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira;(iii) Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt dhe indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar;(iv) Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike etj.;(v) Administrimi i bashkëpronësisë në ndërtesa, në resorte apo struktura turistike dhe në komplekse rezidenciale;(vi) Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj.;(vii) Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe mos shndërrojnë objektin parësor të veprimtarisë së Shoqërisë.	
10. Administratori/ët	Dea Filipi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 23/07/2024	Deri: 23/07/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	a.të kryejë blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta për mallra, punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër e cila nuk është nën përgjegjësinë direkte të Asamblesë së Përgjithshme deri në vlerën e barabartë me 50,000 EUR (pesëdhjetë mijë Euro), për çdo transaksion apo në agregat. b.ka të drejtë të kryejë të gjitha shitjet e njësi/objekteve të banimit dhe/ose shërbimit dhe/ose njësi/objekte të cilësdo natyre qoftë tek klientët e interesuar, në te cilat Shoqëria rezulton të jetë investitore ose përfituese si pronare truall, pa ju nënshtruar kufizimeve të cilësuar në pikën a) më sipër; c.hartojë, formalizojë dhe komunikojë procedurat e brendshme, urdhrat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose rregulloreve të brendshme të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. d.të miratojë dhe lidhë marrëveshje sipas së cilës miratohet vendosja e barrëve siguroese mbi të drejtat ose barrë hipotekore mbi pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të Shoqërisë apo ende në proces zhvillimi nga Shoqëria, në favor të bankave të nivelit të dytë, për të garantuar pagesën e detyrimeve monetare nga ana e klientëve që kanë blerë nga shoqëria, po këto pasuri të paluajtshme nëpërmjet financimit nga bankat e nivelit të dytë. a.të veprojë i vetëm në emër e për llogari të Shoqërisë, lidhur me kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme me qëllim hapjen/mbylljen e llogarive bankare të Shoqërisë pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktivizimin, shfrytëzimin ose çaktivizimin nga ana e Shoqërisë e të gjitha shërbimeve specifike të ofruara nga banka/at lidhur me llogaritë bankare të hapura prej tij; b.të autorizojë i vetëm caktimin/heqjen e personave që kanë të drejta të përdorin dhe të kryejnë veprime nëpërmjet sistemeve të 'online banking' pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	c.të kryejë çfarëdolloj veprimi tjetër që lidhet me administrimin e zakonshëm të përditshëm të Shoqërisë pranë çdo banke të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, që nuk bie ndesh apo kufizohet me vendime të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë apo procedura të tjera të caktuara në këtë Statut apo në ligj.	
12. Ortakët	Balfin - Balkan Finance Investment Group	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 98.050.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	E-Mail: d.filipi@balfin.al Telefon: +355692914550	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 22/03/2025

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2025/03/22 11:35:47 +01:00
M41929022N2025032211353965
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit të kerkimit:	D-20250321155219247
Data e Rezultatit të Kerkimit:	21.03.2025
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	15:52:19
Lloji i Kerkimit:	Emri i Personit Juridik
Numri i Dokumentit:	D-400-113-2428

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

NEW APOLLONIA SH.P.K.

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



SUBJEKTI KERKUES:

Emertimi
ERMAL XHEVDET HAMZAJ P.F.

Ada Qoqja

TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri
ADA QOQJA



Nr. Prot. BI_2025_0306

**VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
"BLESSED INVESTMENT" SH.P.K.**


Sot, më datë 21.03.2025, Ortaku i Vetëm i shoqërisë "BLESSED INVESTMENT" SH.P.K., me seli në adresën: Rruga "Themistokli Gërmenji", Nd. 1, Tiranë, Shqipëri, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L71423028S (në vijim quajtur "**Shoqëria**"), **Z. Besnik Leskaj**, shtetas shqiptar, lindur më 30/06/1976, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.personal H60630112W, merr në shqyrtim dhe vendos për çështjet si më poshtë vijon:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i blerjes nga Blessed Investment sh.p.k të të gjitha kuotave të shoqërisë APOLONIA SEAFRONT PROPERTIES SH.P.K barabarta me 100% (njëqind përqind) të kapitalit të saj, kundrejt një çmimi prej 4,500 LEK (katër mijë e pesëqind).
2. Autorizimi i Administratorit të Shoqërisë për të nënshkruar kontratën e shitblerjes së kuotës, dhe çdo dokument të nevojshëm për përmbushjen e qëllimit në pikën (1) të rendit të ditës.

Shoqëria synon të blejë kuotat e barabarta 100% të kapitalit të shoqërisë APOLONIA SEAFRONT PROPERTIES SH.P.K. e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) M51321056J, me administrator Znj. Anila Xhepa, me seli në Tiranë, në adresën: Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Godina 3 Kati I Tirane, me kapital themeltar 1000 LEK (një mijë), i përbërë nga në 1 kuotë, me konfigurimin e ortakut të vetëm si vijon: Shoqëria "New Apollonia" Sh.p.k pronar i një kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria Apolonia Seafront Properties Sh.p.k. ka për objekt të aktivitetit të saj tregtar (i) Zhvillimi, projektimi dhe ndërtimi i objekteve civile dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë; (ii) Shitja e objekteve/njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira; (iii) Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt dhe indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar etj.





**BLESSED
INVESTMENT**

Rr. "Themistokli Gërmenji",
Nd. 1
Tiranë, Shqipëri

Në vijim të sa më sipër, dhe në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar të zbatuar në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me rendin e ditës, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë,

VENDOSI:

1. Miratimin e blerjes nga Blessed Investment sh.pk të të gjitha kuotave të shoqërisë APOLONIA SEAFRONT PROPERTIES SH.P.K barabarta me 100% (njëqind përqind) të kapitalit të saj, kundrejt një çmimi prej 4,500 Lek (katër mijë e pesëqind).
2. Të autorizojë Znj. Ana Lleshi, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, për të nënshkruar kontratën e shitblerjes së kuotës të miratuar sipas pikës 1 të këtij Vendimi, të firmosë transfertën bankare për pagesën e çmimit të blerjes së kuotës, si dhe për të kryer çdo veprim të nevojshëm për përmbushjen e qëllimit sipas pikës 1 më lart të këtij Vendimi.

Ortaku i Vetëm merr këtë vendim, duke mos patur çështje të tjera për shqyrtim në rendin e ditës.

BLESSED INVESTMENT SH.P.K.

Z. Besnik LESKAJ

Ortak i Vetëm

Besnik Leskaj

BLESSED INVESTMENT SHPK
NIPT: L71423028S





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L71423028S	
2. Data e Regjistrimit	23/02/2017	
3. Emri i Subjektit	BLESSED INVESTMENT	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	17/02/2017	
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/02/2017	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Themistokli Gërmenji, Nd.1	
8. Kapitali	7.000.100,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Zhvillimi i pasurive te paluajtshme; Kryerja e operacioneve ekonomike, juridike e financiare si dhe e cdo biznesi qe lidhen drejteperdrejte ose terthorazi me realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise, brenda kuadrit te dispozitave ligjore. Kryerja e cdo operacioni tregtar, financiar dhe kreditimi, blerje, shitje ose marrje me qera te objekteve te ndryshme te luajtshme e te paluajtshme. Marrja pjese ne shoqeri e ne konsorciume te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjise elektrike nga burime alternative si parqet e eres, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasa etj. Kryerja e cdo aktiviteti te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.	
10. Administratori/ët	Ana Lleshi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 28/04/2017	Deri: 27/04/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	Administratorja mund të nënshkruaj kontrata, transaksione bankare dhe dokumenta me natyrë financiare me vlerë deri në shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) Euro. Për kontrata, transaksione bankare dhe dokumenta me natyrë financiare mbi vlerën 10 000 (dhjetë mijë) Euro, Znj. Ana Lleshi nënshkruan bashkërisht me Ortakun e Vetëm, ose nënshkruan vetëm Znj. Ana Lleshi në bazë të autorizimit paraprak të dhënë me anë të Vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.	
12. Ortakët	Besnik Leskaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 7.000.100,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tiranë Kashar KASHAR Kompleks me 4 (katër) godina banimi dhe shërbimi 9 kate me 2 kate parkim nentoke, Rr. Migjeni, Nj. A. Kashar, Tiranë Shqipëri	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: BLESSED INVESTMENT E-Mail: alleshi@blessedinvestment.com Telefon: +355697034789	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 22/03/2025

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2025/03/22 11:48:37 +01:00
L71423028S2025032211482885
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)